



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1248/2 prot.

Tiranë më 13.102017

REKOMANDIM

Nr. 44, datë 13.10.2017

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Në zbatim të Urdhrit Nr.231, datë 15.09.2017 të Komisioncrit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "BREÇANI – R.O.S.P" sh.p.k Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "BREÇANI – R.O.S.P" sh.p.k Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr.231, datë 15.09.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi "BREÇANI – R.O.S.P" sh.p.k. Tiranë, është subjekt juridik me NIPT: K52116005E, me objekt aktiviteti, sigurimi i objekteve publike dhe private në pronësi ose në përdorim të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të personave fizik, shtetas shqiptar dhe të huaj.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim u konstatua:

1. Nga verifikimi në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese të zyrës së Komisionerit është konstatuar se kontrolluesi ka "Njoftuar" pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit, si dhe ka kryer përditësimet e nevojshme.
 2. Kontrolluesi disponon rregullore për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.
 3. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet e brendshme dhe të jashtme nëpërmjet sistemit të video-survejmimit. Në ambientet e administratës së kontrolluesit, ka kamera vëzhgimi, dhe konstatohet se janë vendosur tabela informuese sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri. Koha e ruajtjes së të dhënave në sistem konstatohet të jetë 15 ditë, sipas dhe rregullave e politikave mbi sistemin e mbikëqyrjes me kamera CCTV.
 4. Kontrolluesi informon subjektet e të dhënave "punëmarrës" në lidhje me përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit gjeolokalizimit (GPS) të vendosura në mjetet motorrike të kompanisë, gjatë lëvizjeve të tyre me qëllim ushtrimin e detyrave të ngarkuara.
 5. Kontrolluesi nuk ka publikuar "Politikat e Privatësisë", në portalin zyrtar të <http://www.breccani-security.com>. Informacioni i publikuar në "Politikat e Privatësisë", ka për qëllim informimin e subjekteve që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.
- Konstatimi i pikës së pestë, përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, i cili shprehet:

"1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij.

2. Në rast se kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra nga subjekti i të dhënave, ai është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare. Nëse subjekti i të dhënave, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor, është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, kontrolluesi e informon edhe rreth këtij fakti, si dhe rreth pasojave të refuzimit të dhënies së të dhënave personale".

6. Kontrolluesi aplikon "Deklaratë konfidencialiteti", nënshkruar nga punonjësit e kompanisë të cilët kanë akses në të dhëna personale, por kjo deklaratë nuk është sipas standardit të miratuar nga Komisioneri, konform Vendimit Nr.6 datë 05.08.2013 të Komisionerit, ku parashikohen: **Objekti, qëllimi, fusha e veprimit, masat për shpërdorimin e tyre, si dhe nënshkrimin e punëdhënësit.**

Konstatimi i pikës së gjashtë, përbën shkelje administrative të nenit 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, i cili shprehet:

- "Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj".

7. Kontrolluesi "BRECANI R.O.S.P" sh.p.k. Tiranë, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij ofron shërbimin të kompanive të ndryshme. Në marrëdhëniet kontraktuale të kontrolluara, u konstatua se nuk ka marrëveshje konfidencialiteti mes palëve, konform aktit nënligjor të Komisionerit, Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012, "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi".

Pavarësisht statusit të palëve kontraktuale, "kontrollues" apo "përpunues" detyrimet që burojnë nga ligji (neni 20) janë taksative. Të dyja palët duhet të jenë ndërvetpruese dhe jo të mbeten në kushtet e mosveprimit.

Konstatimi i pikës së shtatë, përbën shkelje administrative të nenit 20 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, i cili shprehet:

– "1. Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. **Çdo përpunues i të dhënave personale ka këto detyrime:**

- a) të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit; të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi;
- b) të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;
- c) të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale;
- d) t'i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna ose t'i mbajë apo t'i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit;
- e) të vërë në dispozicion të kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm, për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet, që rrjedhin sipas shkronjave të mësipërme.

2. Detyrimet e pikës 1 përcaktohen në kontratën e shkruar e kontrolluesit me përpunuesin".

Në të tilla kushte, kontrolluesi është i obliguar të nënshkruajë marrëveshjet e konfidencialitetit me ofruesit e shërbimeve, sipas standardit të përcaktuar në Udhëzimin Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit. Gjithashtu, marrëveshjet e konfidencialitetit do të nënshkruhen dhe kur kontrolluesi gjendet në kushtet e përpunuesit dhe akseson të dhëna personale të kontrolluesve të tjerë, të cilëve ju ofron shërbimin e tij.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "BREÇANI – R.O.S.P" sh.p.k. Tiranë, të hartojë dhe publikojë në portalin zyrtar të tij, rubrikën "Politikat e Privatësisë".
2. Në zbatim të nenit 20 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "BREÇANI – R.O.S.P" sh.p.k. Tiranë të nënshkruajë marrëveshjet e konfidencialitetit me ofruesit e shërbimeve, sipas standardit të përcaktuar në Udhëzimin Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi", edhe në rastet kur gjendet në kushtet e përpunuesit e akseson të dhëna personale të kontrolluesve të tjerë.
3. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "BREÇANI – R.O.S.P" sh.p.k. Tiranë, të standartizojë Deklaratat e konfidencialitetit me punëmarrësit, sipas Vendimit Nr.6 datë 05.08.2013 të Komisionerit.
4. Kontrolluesi "BREÇANI – R.O.S.P" sh.p.k. Tiranë, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 në vazhdimësi dhe për pikën 3 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13/10/2017

KOMISIONERI
Besnik Dervishi